

V E N D I M
Nr. 295, datë 27.6.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KORÇË-KAPSHTICË NË
TERRITORIN E QARKUT KORÇË**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë-Kapshticë në territorin e Qarkut të Korçës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 19 989 m² tokë/arë, 4 996 m² truall, 496 m² ndërtesë, 5 pika karburanti me vlerë 14 366 913 lekë, 85 m² fidanë plepi dhe 125 dru frutorë.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 568 000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekësh.
 5. Fondi prej 47 441 894 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e dyzet e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.6.2002.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko